



Procedura

Procedura

Kategoria
**Kategoria e
ulët dhe e
mesme
drejtuese**

Lëvizja paralele

Ngritje në detyrë

Pozicioni

**Përgjegjës në Sektorin e Ndjekjes së Investimeve dhe Kontratave
publike pranë Drejtorisë së Projekteve , Infrastrukturës Publike dhe
Transportit Publik**

Në zbatim të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM nr.242 datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, në Urdhrin nr.20 prot 1042 datë 21.01.2026, si dhe në Vendimin nr.01 datë 12.01.2026 “Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrës”, , Bashkia Durrës shpall konkurimin për pozicionin :

**Përgjegjës në Sektorin e
Ndjekjes së Investimeve dhe
Kontratave publike pranë
Drejtorisë së Projekteve ,
Infrastrukturës Publike dhe
Transportit Publik**

Lloji i Diplomës
**Inxhinieri Ndertimi,
Arkitekture, Topografi,
Inxhinieri elektrike, Inxhinieri
Hidroteknike**

Niveli minimal i Arsimimit

DND

Kategoria

III-2

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranim nga jashtë shërbimit civil.

Afati për dorëzimin e dokumenteve për: LËVIZJE PARALELE

02.02.2026

Afati për dorëzimin e dokumenteve për: NGRITJE NË DETYRË

06.02.2026

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Organizon, drejton dhe koordinon punën për zbatimin e investimeve publike të Bashkisë, duke siguruar realizimin e tyre brenda afateve të përcaktuara dhe me cilësinë e parashikuar në kontrata, në përputhje me projektet e miratuara, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, si dhe aktet nënligjore në fuqi për investimet publike.
- Ushtron mbikëqyrjen teknike dhe administrative të kontratave të punëve publike, nëpërmjet kontrolleve periodike në terren, individualisht ose në bashkëpunim me specialistët e sektorit të autorizuar, me qëllim garantimin e respektimit të detyrimeve kontraktuale dhe ligjore, efektivitetit, cilësisë së punimeve dhe përdorimit të fondeve publike sipas destinacionit.
- Konstaton shkeljet e mundshme gjatë zbatimit të kontratave dhe propozon masa administrative, teknike ose ligjore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përcaktimet kontraktuale, si dhe përgatit raportime periodike teknike dhe financiare mbi ecurinë e investimeve publike.
- Përgatit dhe ndjek procedurat për emërimin e komisioneve të kolaudimit të objekteve të përfunduara, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore, si dhe monitoron periodikisht objektet që ndodhen në periudhën e garancisë, duke evidentuar dhe ndjekur zbatimin e detyrimeve të kontraktorit.
- Përgatit informacione, raporte dhe materiale për Bashkinë, në cilësinë e investitorit, mbi ecurinë e procedurave dhe realizimin e projekteve të investimeve publike, evidenton problematikat e hasura gjatë procesit të zbatimit dhe ndjek marrjen e masave konkrete deri në zbatimin e plotë të tyre.
- Përgatit relacionet dhe dokumentacionin shoqërues për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak, në përputhje me kompetencat e këtij organi dhe kërkesat e legjislacionit përkatës.
- Siguron zbatimin e rregullores së brendshme të Bashkisë, legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore nga punonjësit e sektorit të ndjekjes së investimeve publike.
- Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga eprori i drejtpërdrejtë ose titullari i institucionit, në përputhje me funksionet, përgjegjësitë dhe kompetencat e sektorit.

I. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta:

- a) të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë III-2;

- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- d) të ketë eksperiencë 5 vjet
- e) të jetë njohës i mirë i gjuhës angleze
- f) të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

1.2 Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b) Fotokopje të diplomës dhe listes së notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Fotokopje të kartes së identitetit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet me postë ose dorazi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore apo Zyrën e Protokollit në Bashkinë Durrës në adresën- Bashkia Durrës, Sheshi “Liria”, 2000 Durrës

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve për lëvizjen paralele duhet të bëhet brenda datës:
02.02.2026

1.3 Rezultatet për fazën e seleksionimit paraprak

Në datën **04.02.2026**, Bashkia Durrës do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al) dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

1.4 Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervist

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar

Ligjin nr. 44/2014 datë 24.4.2014 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”

Ligjin nr. 9131 dt. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”

Ligjin nr. 139 dt. 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar

Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

Ligjin nr 7961 dt. 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë” (i ndryshuar)

Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar,

VKM nr.354 datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”,

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 448, datë 31.7.2025 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit”,

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 610, datë 22.9.2022” Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”,

Udhëzim Nr .2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

1.5 Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

a) Vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar: (40 pikë)

Vlerësimi i jetëshkrimit, eksperiencës, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet positive.

b) Vlerësimi gjatë intervistës së strukturuar me gojë: (60 pikë)

- ✓ Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- ✓ Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- ✓ Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

1.6 Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Durrës do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës jo fitues në këtë procedurë do të njoftohen individualisht për rezultatet në mënyrë elektronike (nëpërmjet adresës së e-mail)

II. NGRITJE NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Bashkisë.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1 Kushtet për ngritje në detyrë dhe kriteret e veçanta

Arsimi: *Inxhinieri Ndertimi, Arkitekture, Topografi, Inxhinieri elektrike, Inxhinieri Hidroteknike*

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a) të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë IV-2, IV-3;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- d) të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurim
- e) Njohës i mirë i gjuhës angleze në të shkruar dhe të lexuar

2.2 Dokumentet, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b) Fotokopje të diplomës dhe liste notash (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- c) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

- i) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet me postë ose dorazi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore apo Zyrën e Protokollit në Bashkinë Durrës në adresën - Bashkia Durrës, Sheshi "Liria", 2000 Durrës

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve për Ngritje në detyrë duhet të bëhet brenda datës:
06.02.2026

2.3 Rezultatet për fazën e seleksionimit paraprak

Në datën **09.02.2026**, Bashkia Durrës do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al) dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën për konkurimin për këto pozicione, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

2.4 Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

Ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit"

Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar

Ligjin nr. 44/2014 datë 24.4.2014 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"

Ligjin nr. 9131 dt. 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike"

Ligjin nr. 139 dt. 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar

Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"

Ligjin nr 7961 dt. 12.07.1995 "Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar)

Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar,

VKM nr.354 datë 11.5.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim",

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 448, datë 31.7.2025 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit",

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 610, datë 22.9.2022" Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e

përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”,
Udhëzim Nr .2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

2.5 Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

a) Vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar: (20 pikë)

Vlerësimi i jetëshkrimit, eksperiencë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet positive.

b) Vlerësimi me shkrim: (40 pikë)

c) Vlerësimi gjatë intervistës së strukturuar me gojë: (40 pikë)

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

2.6 Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Durrës do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës jo fitues në këtë procedurë do të njoftohen individualisht për rezultatet në mënyrë elektronike (nëpërmjet adresës së e-mail).